



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 156, Datë 13.06.2022

MBI

MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT TË ERE-S, “MBI ZBATIMIN E  
REKOMANDIMEVE SIPAS AUDITIMIT TË KRITEREVE TË PERFORMANCËS  
PËR ENTIN RREGULLATOR TË ENERGJISË GJATË VITIT 2021”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 03.09.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.06.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 771/8 prot., datë 20.05.2022 “Mbi miratimin e planit të veprimeve të ERE-s, “Mbi zbatimin e rekomandimeve sipas auditimit të performancës për Entin Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2021”,

**Konstatoi se:**

- ERE në zbatim të parashikimeve të nenit 17, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; bazuar në urdhërat e kryetarit të ERE ka kryer auditimin e performancës dhe atë financiar për vitin 2021.
- Në letrën e drejtimit të datës 17.03.2022, Audituesi ligjor ka adresuar disa çështje për vëmendjen e Drejtuesve dhe bordit të ERE-s.
- Me qëllim marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve referuar letrës për drejtimin të datës 17.03.2022, është përgatitur plani i veprimeve për ndjekjen dhe implementimin e këtyre rekomandimeve.
- Në kuptim të këtij Plani veprimesh kërkohet angazhimi i strukturave organizative të ERE-s për ndjekjen dhe kryerjen e detyrave brenda afateve të vendosura sipas dokumentit bashkëlidhur këtij vendimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Miratimin e planit të veprimeve të ERE-s, “Mbi zbatimin e rekomandimeve sipas auditimit të kritereve të performancës për Entin Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2021”.  
(Bashkëlidhur).

2. Çdo strukturë organizative të përgatisë një informacion periodik, për bordin e ERE-s, mbi implementimin e Planit të masave “Mbi zbatimin e rekomandimeve sipas auditimit të kriterëve të performancës për Entin Rregullator të Energjisë gjatë vitit 2021” sipas afateve të përcaktuara në këtë Plan.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**